2-180/4525
30/06/2026

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 002/35
Datë: 30.06.2026

Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenit 40, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 dhe nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 10, paragrafi 3 dhe nenit 15, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, si dhe Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Vendimit të Ministrisë së Mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës Nr.5463-2/25, datë 20.08.2025 , për pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave për rajonin e Dukagjinit , si dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.06.2026, merr këtë:

VENDIM
Për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Dukagjinit

1. Me këtë Vendim miratohet Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Dukagjinit,

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit),

3. Për Zbatimin e këtij Plani, përgjegjës është Autoriteti Komunal i Komunës së Junikut,

4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 2-180/7547 per miratimin e PNMIM,

5. Ky Vendim hyn në fuqi (30) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale dhe (7) ditë pas publikimit në web faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Ministria e Mjedisit,Planifikimit dhe Infrastrukturës,
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike,
4. Kryetari i Komunës së Junikut;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z.Leonard Lidhumi

Adresa:
Tel.: +383 (0) 49 760 282
http://kk.rks-gov.net/junik